

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k.

Sot, më datë 3 Qershor të vitit 2024 (*dy mijë e njëzet e katër*) ortakët:

Fatmir HASANAJ biri i Fevriut, i datëlindjes 20.08.1963, lindur dhe banues në L. “ 29 Nëntori”- Vlorë, me K. Identiteti Nr. G30820225P,

Ermioni HASANAJ biri i Grazianos, i datëlindjes 20.09.1977, lindur dhe banues në L. “ 29 Nëntori”- Vlorë, me K. Identiteti Nr. H75920127H.

Vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon:

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) me emërtimin “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k.

Ortakët e kësaj Shoqërie janë:

Fatmir HASANAJ dhe Ermioni HASANAJ
Administrator i shoqërisë është z. Fatmir HASANAJ.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të çmohet e aresyeshme prej saj me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k. gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statusit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Qendra e saj është në Vlorë, të rrethit Vlorë.

Statuti i shoqërisë i bashkëlidhet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria ka vulën me përmbajtjen : Shoqëria “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k..

Neni 3

Veprimtaria e saj si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore mbi 10 vjet.

Neni 4

Shoqëria “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k. do të ketë si objekt:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- Aktivitet në fushën e ndërtimit, si objekte, rrugë, kanalizime, vepra arti(Ura), Ujësjellësa etj. shfrytëzim i gjithë produkteve dhe nënprodukteve të materialeve të ndërtimit, prodhimi dhe shitja e materialeve të ndërtimit, eksport dhe import me shumicë dhe pakicë të tyre, shitje-blerje makinerish pune të përpunimit të materialeve të ndërtimit dhe nënprodukteve të tyre,
- aktivitet transporti kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash, makineri, pajisje dhe lënde të para.
- Prodhim dhe tregtim i inerteve, parafabrikateve dhe granileve, ndërtim i objekteve te ndryshëm industriale e civile, rrugë, kanalizime, ujësjellës, rikonstruksione, riparime të ndryshme etj.
- Me zgjerimin e aktivitetit, Shoqëria " ALB NDËRTIM @ BETON " Sh. p. k., ka të drejtë të bëjë shtesa në objekt, ose edhe ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke kryer respektivisht ndryshimet përkatëse në Statut.
- Veprimtari në tregun imobilira.

Neni 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqint mijë) Lekë. Ortakët marrin pjesë në të si më poshtë:

- Fatmir HASANAJ, kontribuon në shumën 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 51 %, dhe
- Ermioni HASANAJ, kontribuon në shumën 49.000 (dyzet e nëntë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 49 %.

Neni 6

Fitimi NETO që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të ndahet në bazë të kuotave që zotëron secili prej ortakëve në shoqëri.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë të kësaj shoqërie, ajo do të përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 8


Marrëdhëniet e punës ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9


Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e shoqërisë si e lexuan me vëmendje aktin e themelimit të mësipërm dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e firmosin pa vërejtje.

ORTAKËT e SHOQËRISË

Fatmir HASANAJ



Ermioni HASANAJ



STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALB NDËRTIM @ BETON“ Sh.p.k.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e themelimit, emri dhe themeluesit

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është krijuar nga themeluesit dhe ortakët: Fatmir HASANAJ dhe Ermioni HASANAJ, që prej ditës 03.06.2024, në bazë të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarë dhe Shoqëritë Tregtare”.

Shoqëria e krijuar është me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh. p. k., me adresë: Lagjia: “Uji i Ftohtë”, Pallati “Oslo”, 9402-Vlorë.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- Aktivitet në fushën e ndërtimit, si objekte, rrugë, kanalizime, vepra arti(Ura), Ujësjellesa etj. shfrytëzim i gjithë produkteve dhe nënprodukteve të materialeve të ndërtimit, prodhimi dhe shitja e materialeve të ndërtimit, eksport dhe import me shumicë dhe pakicë të tyre, shitje-blerje makinerish pune të përpunimit të materialeve të ndërtimit dhe nënprodukteve të tyre,
- aktivitet transporti kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash, makineri, pajisje dhe lënde të para.
- Prodhim dhe tregtim i inerteve, parafabrikateve dhe granileve, ndërtim i objekteve te ndryshëm industriale e civile, rrugë, kanalizime, ujësjellës, rikonstruksione, riparime të ndryshme etj.
- Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria " ALB NDËRTIM @ BETON " Sh. p. k. , ka të drejtë të bëjë shtesa në objekt, ose edhe ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke kryer respektivisht ndryshimet përkatëse në Statut.
- Veprimtari në tregun imobilira.

Neni 3:

Kohëzgjatja


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet.

Neni 4:

Selia

Selia e Shoqërisë “ALB NDËRTIM @ BETON” SH.P.K. ndodhet në adresë: Lagjia: “Uji i Ftohtë”, Pallati “Oslo”, 9402-Vlorë.

KREU II
KAPITALI I REGJISTRUAR



Neni 5:

Vlera dhe pagesat e Kapitalit

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqint mijë) Lekë, i përberë nga dy kuota. Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre respektivisht:

- Fatmir HASANAJ, kontribuon në shumën 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) Lekë, pra 1 (një) kuota në raportin 51 %, dhe
- Ermioni HASANAJ, kontribuon në shumën 49.000 (dyzet e nëntë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuota në raportin 49 %.

Neni 6:

Kalimi i kapitaleve në shoqëri

Këto kontribute janë paguar plotësisht dhe kanë kaluar në pronësi të shoqërisë.

Neni 7:

Kuotat

Kuotat janë pronë e ortakëve të shoqërisë.

Neni 8:

Çertifikatat e kuotave

Ortakët kanë të drejtë të përfitojnë një certifikatë për kuotat e zotëruar prej tyre. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letres me vlerë.

Neni 9:

Kalimi i kuotave me Trashëgimi

Nëse njëri prej ortakëve ndërron jetë, trashëgimtari ose trashëgimtarët do të jenë personat e vetëm të njohur nga ligji si gëzues të së drejtave mbi kuotat e tij; pasuria e ortakut të vdekur nuk lirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotat e zotëruara nga ai.

Neni 10:

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Ortakët, mund të zmadhojnë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e tij në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës të ortakëve. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

**KREU III
ADMINISTRATORI**

Neni 11:
Emërimi i Administratorit

Ortakët zgjedhin një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare.

Administator i Shoqërisë “ALB NDËRTIM @ BETON” Sh.p.k., emërohet njëri prej ortakëve themelues z. Fatmir HASANAJ, për një periudhë 5(pesë)-Vjeçare i cili caktohet edhe Kryetar i mbledhjeve.

Neni 12
Kompetencat e Administratorit

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat për administrimin dhe mbarëvajtjen e shoqërisë, përfaqësimin në raport me të tretët. Disa prej të drejtave:

Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.

Të bëjë propozimet e nevojshme, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.

Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë.

Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.

Të propozojë për krijimin e njësive, strukturave si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit apo jashtë shtetit.

Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të ortakëve.

Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij. Administratori nuk mund të delegoj detyrimet e tij ligjore.

Neni 13:
Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit perfundon në rast se:

1. personi nuk është korrekt në kryerjen e detyrës së tij
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueuse;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi dhe Ortakët vendosin ta shkarkojnë nga detyra.

Neni 14:
Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

Administratori shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Ortakët ku ata mund të parashikojnë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

Neni 15:

Kufizimet në Votimet e Administratorit

Në rastet kur ka më shumë se një administratore, ata nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material.

Neni 16:

Proçesverbalet e Mbledhjeve

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen proçesverbalet e të gjitha takimeve të kryera; dhe të gjitha mbledhjet e ortakëve, etj.

KREU IV

DIVIDENDET DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 17:

Dividendet

Ortakët mund të deklarojnë shpërndarjen e dividendëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara.

Neni 18:

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori pas vendimit të marrë nga Ortakët mund të vendos të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU V

PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 19:

Prishja dhe likuidimi

Ne rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë nga ortakët, mund të shpërdaj shoqërinë, mjetet financiare si dhe çdo pronësi tjetër e fituar si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë kur shoqëria likuidohet, i takon ortakëve.

Statuti është hartuar në përputhje me nenet e Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008.

ORTAKËT e SHOQËRISË

Fatmir HASANAJ



Ermioni HASANAJ

